

RAPORTI VJETOR 2019



INITIATIVE FOR AGRICULTURAL DEVELOPMENT OF KOSOVO
INICIATIVA PËR ZHVILLIMIN E BUJQËSISË SË KOSOVËS
INICIATIVA ZA POLJOPRIVREDNI RAZVOJ KOSOVA



T ë jetojmë nga toka dhe puna jonë

Përmbajtja

1. Përmbledhje nga të arriturat.....	6
2. Profili i organizatës.....	8
3. Partnerët dhe Donatorët e IADK-së.....	8
4. Krijimi i vendeve të punës dhe rritja e të ardhurave për grupet e targetuara.....	9
5. Praktika në punë ofronë mundësi punësimi për të rinjë/studentë.....	9
6. Punësimi i grave përmes trajnimeve dhe mbështetjes për hapje të bizneseve.....	10
7. Bimët Mjekuese dhe Aromatike si sektor potencial për punësim, gjenerim të ardhurave dhe rritje të eksportit.....	12
8. Kultivimi i perimeve në serra, mundësi punësimi dhe krijimi të të ardhurave për fermerët.....	16
9. Kultivimi i pemëve sjellë përfitime afatgjate për përfituesit e IADK-së.....	17
10. Blegtoria një sektor me potencial për punësim dhe gjenerim të të ardhurave.....	18
11. Përmbledhje të rezultateve.....	21
12. Publikimet.....	22
13. Vizitat lokale dhe regjionale.....	22
14. Struktura organizative e IADK-së dhe stafi i saj.....	23
15. Të hyrat e IADK-së nga donatorët për vitin 2019.....	24
16. Të hyrat e IADK-së nga partnerët për vitin 2019.....	25

Të nderuar lexues,

Bashkëpunimi dhe koordinimi i aktiviteteve me të gjithë ju padyshim që është edhe sukcesi i punëve të përbashkëta që kemi arritur. Bujqësia vazhdon të mbetet një nga shtyllat kryesore për punësim dhe gjenerim të të ardhurave. Gjatë vitit që shkoj, së bashku me të gjithë partnerët, donatorët, fermerët dhe ekipin e organizatës kemi arritur të ndikojmë pozitivisht në zhvillimin e bujqësisë së Kosovës, duke rritur të ardhurat për fermerët, punësuar të rinjë dhe të reja, duke hapur biznese që kanë për qëllim punësimin e grave dhe grupeve të marginalizuara.

Padyshim, viti 2019 do të kujtohet si një nga vitet më të suksesshme për IADK-në. Ne kishim më shumë donator dhe partnerë që besuan në punën tonë, krijuam partneritet strategjik me shumë organizata dhe institucione lokale, ndikuam në zhvillimin e pothuajse të gjithë sektorëve që kanë mundësi zhvillimin dhe gjenerimi të të ardhurave dhe ndihmuam shumë gra, të rinjë, minoritete dhe grupe të marginalizuara që edhe ato të kenë një jetë më të dinjitetshme.

Gjatë vitit që lam pas, IADK ka vendosur pikat kryesore për finalizimin e strategjisë së saj për periudhën 10 vjeqare, ky dokument do të ndihmojë organizatën në orjentimin e saj strategjik për periudhën e ardhshme, njëkohësisht do të ndihmojë në zhvillimin e bujqësisë. Gjatë këtij viti IADK ka arritur të bëjë ri-akreditimin e organizatës si dhe ri-validimin e programit të blegtorisë nga AKK.

Në zhvillimin e bujqësisë, përveç IADK-së, një kontribut kanë dhënë edhe organizatat tjera dhe institucionet publike. Pamvarësisht zhvillimeve pozitive, ne konsiderojmë se bujqësia ende vazhdon të mbetet një sfidë e cila kërkon kujdes dhe përkrahje. Në këtë kontekst do të vazhdojë të potencoj që zbatimi i ligjeve në bujqësi nga


institucionet relevante mbetet prioritet, sa kaq edhe ndryshimet në strategjitë zhvillimore kërkojnë të trajtohen me aq prioritet. Mos zbatimi i ligjeve dhe mos adaptimi i strategjive në disa raste ka ndikuar edhe negativisht në zhvillimin e bujqësisë, po aq sa ka krijuar edhe konfuzitet tek fermerët, kryesisht fermerët e vegjël.


IADK, do të vazhdojë të mbështesë zhvillimin e bujqësisë, do të identifikojë dhe adresojë nevojat e fermerëve, do të jetë partner strategjik dhe i besueshëm për donatorët e ndryshëm. Prandaj, si drejtor i organizatës dhe në emër të bordit të drejtorëve dhe të gjithë stafit të organizatës, do të falenderojë secilin nga ju për bashkëpunimin dhe kontributin e dhënë në zhvillimin e bujqësisë në Kosovë.

I juaji
Zenel Bunjaku




1. Përmbledhje nga të arriturat







Vende pune për 12 të rinjë
të gjeneruar si rezultat i
praktikës në punë



5
biznese të reja
për punësim të
grave



Përfliuesit sipas përkatësisë etnike



2 tharrëse termike
për pikat
grumbulluese



Afër 75 kultivues të perimeve në serra, kanë
gjeneru të ardhura nga 1200 deri 1600 euro

Pikat grumbulluese me tharrëse termike
kanë gjeneru të ardhura mbi 10000 euro

111 kultivues të BMA-ve kanë arritur të
shtojnë të ardhurat familjare për 800 euro

2. Profili i organizatës

Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës (IADK) është një organizatë jo profitabile, jo qeveritare e themeluar në vitin 2004. Misioni i organizatës është të promovojë zhvillimin socio ekonomik në zonat rurale, të zvogëlojë papunësinë dhe të krijojë të ardhura ekonomike, duke zvogluar migrimin e popullësisë në zonat urbane. Synon grupet më në nevojë, duke mbështetur fermerët, ata të cilët kanë të hyra të ulëta dhe jetojnë në kushte të vështira ekonomike, mbështetë të rinjët dhe studentët duke përgatitur ata për tregun e punës, dhe padyshim një fokus grup me interes janë gratë, minoritetet dhe grupet e marginalizuara. IADK ka për qëllim të ndikojë në zhvillimin e bujqësisë, duke adresuar problemet në sektorët bujqësorë që do të rezultojë në përmirësimin e cilësisë dhe sasisë së produkteve bujqësore, ngritjen e shkathtësive, konkurrencës së fermerëve dhe fuqizimin e rolit të fermerëve. Për këtë qëllim, IADK ka një bashkëpunim të suksesshëm me fermerët, shoqatat e fermerëve, zyrtarët komunal dhe qeveritarë. Qëllimi primar i organizatës është rritja e konkurrencës në treg, ofrimin e praktikave të mira bujqësore dhe të përpunimit, dhe promovimin dhe zbatimin e standardeve të BE-së. Organizata përbëhet nga një ekip profesional, me një ekspertizë në fushat e ndryshme të bujqësisë dhe mbulon tërë territorin e Kosovës. IADK ka një bashkëpunim të suksesshëm me donatorë të shumtë nga Bashkim Evropian, nga Qeveria Gjermane, Zvicrane etj.

3. Partnerët dhe Donatorët e IADK-së

IADK ka ndërtuar një partneritet strategjik dhe të qëndrueshëm me donatorë dhe partnerë në nivel vendi dhe atë ndërkombëtar. Zhvillimi dhe fuqizimi i IADK-së është falë bashkëpunimit, profesionalizimit dhe përgjegjshmërisë që stafi i saj ka treguar me donatorë të ndryshëm. IADK vazhdon të jetë një lider i zhvillimit të bujqësisë në Kosovë dhe atë falë një numri të donatorëve që kontribuojnë në realizimin e shumë aktiviteteve në të mirë të komuniteti:

- **Brot für die Welt (BfdW):** "Mundësimi i vetpunësimit të rinisë dhe grupeve të marginalizuara në viset rurale të Kosovës"
- **Brot für die Welt (BfdW):** "Përkrahja e fermerëve të vegjël me pajisje dhe promovimi i energjisë së ripërtërishme"
- **UNDP:** "Mbështetja e fuqizimit ekonomik të fermerëve të vegjël në komunat veriore të Rajonit të Mitrovicës"
- **GIZ:** "Mbështetja e zinxhirit të vlerave të BMA përmes krijimit të punësimit dhe vazhdimin të eksportit"

- **GIZ** "Përfshirja ekonomike e të riatdhesuarve përmes bujqësisë në zonat rurale dhe ngritja e kapaciteteve përmes trajnimeve profesionale"
- **KCSF:** "Ngritja e kapaciteteve profesionale të të rinjve në sektorin e bujqësisë"
- **KCSF:** "Promovimi i MSA dhe rëndësisë së eksportit të produkteve bujqësore"
- **KCSF:** "Monitorimi i procesit të konsultimeve publike në nivel të qeverisë"
- **DRC:** "Mbështetja e Ndërmarrësisë Shoqërore dhe Promovimi i Fuqizimit Social-ekonomik në Komunitetet Minoritare në Kosovë"
- **CFD:** Ofrimi i trajnimeve profesionale dhe mundësive për gjenerim të të ardhurave në bujqësi për gratë dhe të rinjët në zonat rurale të Kosovës.
- **CARE:** IADK ka ofruar shërbime këshillimore për klientët me qëllim të realizimit të aktiviteteve bujqësore.

IADK këtë vit po ashtu ka vazhduar të jetë pjesë e rrjeteve në nivel të Kosovës siç janë: RRGK, CiviKos si dhe ato në nivel të BE: EUFRAS dhe SEASN, ku në takimin e saj përfaqësuesi i IADK-së është zgjedhur anëtar i bordit si dhe nënkryetar i rrjetit.

4. Krijimi i vendeve të punës dhe rritja e të ardhurave për grupet e targetuara

Qëllimet dhe objektivat e IADK-së janë përmirësimi i kushteve të jetesës për të rinjtë, gratë, minoritetet dhe grupet e marginalizuara. Viti 2019 është karakterizuar me plotë suksese të cilët kanë sjellë punësim dhe gjenerim të të ardhurave për përfituesit në zonat rurale. Një rol të rëndësishëm kanë luajtur të gjithë partnerët, donatorët dhe stafi i organizatës IADK. Raporti në vazhdim do të paraqes të arriturat e organizatës për vitin 2019 në bazë të storieve të suksesit për të gjitha grupet e përkrahur.

5. Praktika në punë ofronë mundësi punësimi për të rinjë/studentë




Kosova ka një popullësi të re, përafërsisht 53% e popullësisë është nën moshën 25 vjeq. Me një popullsi të tillë, shteti ynë mund të përfitojë duke investuar në edukim dhe aftësim të tyre. Shkalla e papunësisë vazhdon të jetë e lartë, afër 52.7% e të rinjve të aftë për punë vazhdojnë të kenë vështirësi në gjetjen e një pune të qëndrueshme. Lenda Ramadani nga Komuna e Gjilanit, është një nga të rinjtë që kishte vështirësi në gjetjen e një vendi pune. Ajo u diplomua në Fakultetin e Bujqësisë, por mundësitë për punë ishin të limituara, marrë parasysh edhe mungesën përvojës praktike të saj. Falë projektit "Ngritja e

kapaciteteve profesionale të të rinjëve në sektorin e bujqësisë" financuar nga Qeveria e Duketit të Madh të Luksemburgut dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) dhe zbatuar nga IADK, ëndrrat e Lendës u bënë realitet. Lenda filloi punën praktike në kompaninë "Fluidi" dhe për tre muaj përvetësoi praktikat e mira duke ngritur kapacitetet teknike dhe profesionale në teknologjinë e përpunimit dhe prodhimit të vajit. Vullneti dhe dëshira, po aq sa përkushtimi për punë gjatë këtyre tre muajve, pa dyshim bëri që Lenda të shikojë për mundësi punësimi. "Isha në dijeni për mundësitë që ofronte kompania ku unë kisha kry praktikën, andaj edhe vendosa që të shpreh interesimin për punë". Kompania Fluidi, vlerësoi pozitivisht shkathtësitë e Lendës, andaj pa mëdyshje vendosën që ta pranojnë atë në punë, në pozitën laborante.

"ëndrra ime tani është bërë realitet dhe kjo falë mbështetjes pa rezervë të organizatës IADK dhe mundësive të ofruara nga kompania Fluidi, për këtë do të jem falenderuese pasi tani kam një punë, krijoj të ardhura për vete dhe familjen – përfundon storien Lenda".

Mundësi në ngritjen e kapaciteteve teknike dhe profesionale janë ofruar edhe për 11 të rinjë/student në projektin e financuar nga BfdW, 4 në projektin financiar nga CFD, 21 në KCSF dhe 2 në projektin e financuar nga GIZ.

Fatmirësisht, nga totali prej 38 praktikantëve/ studentëve, mundësi punësimi deri më tani kanë gjetur 12 të rinjë në organizata, kompani dhe institucione publike. Gjithashtu, të tjerët janë përgatitur teknikisht dhe profesionalisht për tregun e punës dhe sot gëzojnë një mundësi të mirë për punësim.



6. Punësimi i grave përmes trajnimeve dhe mbështetjes për hapje të bizneseve

Të dhënat statistikore për përfshirjen dhe punësimin grave janë shqetësuese dhe dekurajuese për shoqërinë Kosovare. Gratë të cilët jetojnë në zonat rurale i takojnë një grupi të shoqërisë mjaft të pafavorizuar. Ato vazhdojnë të ballafaqohen me shumë kufizime në aspektin ekonomik dhe shoqëror. Në përgjithësi, Kosova është një nga vendet me shkallën më të ulët të punësimit të grave, përafërsisht vetëm 12.7% e grave në moshë pune sot janë të punësuar. Në këtë drejtim, ka një progres këto vitet e fundit, megjithatë gratë vazhdojnë të kenë qasje të kufizuar në ndërmarrësi dhe në financa. Gratë, zakonisht ballafaqohen me diskrimin ekonomik, më pak se 10% e bizneseve në Kosovë menaxhohen dhe udhëheqen nga gratë. IADK, vazhdon të mbështesë gratë përmes skemave të ndryshme, hapje të bizneseve, trajnime profesionale e teknike, me të vetmin qëllim punësimin dhe përfshirjen e grave në shoqërinë Kosovare.

Sot, falë mbështetjes nga IADK gjatë vitit 2019 janë krijuar pesë (5) biznese të reja në fushën përpunimit dhe ushqimeve "byfe", përpunimit të pemëve & perimeve dhe prodhimit të ëmbëlsirave. Si rezultat i këtij investimi, 9 gra kanë ngitur aftësitë profesionale dhe teknike në profesionet e kërkuara, në Komunitat Shtime,

Lipjan, Ferizaj dhe Zveçan në kuadër të projekteve të financuara nga CFD, DRC, BfdW dhe UNDP.

Byfeja mundësi punësimi për gratë: një fat të tillë e kishin 4 gra nga Komuna e Shtimes, të cilët me ndihmën e IADK-së bënë të mundur hapjen e byfësë në shkollën fillore "Lasgush Poradeci" në emër të shoqatës "4 stinët". Zonjat, sot ndihen ekonomikisht të përgatitura, profesionalisht të afta në përgatitjen e ushqimeve për nxënësit dhe stafin e shkollës.



Angazhimi në byfe na bënë të ndihemi krenar shprehet zonja Shukrie Avdiu, pasi përpos punës në shitjen e ushqimeve, ndihemi që bëjmë edhe një punë humane pasi ofrojmë ushqim për nxënësit e shkollës.

Fillimisht, e kishim të vështirë hyrjen në tregun e punës, pasi si gra në zonat rurale puna jonë primare ishin obligimet familjare, duke marrë parasysh edhe normat shoqërore që ekzistojnë në komunën tonë. Mirëkuptimi familjar dhe përgjegjësia që morrëm, na mundësojë të sfidojmë veten duke punuar për mirëqenjen e familjeve tona. Një mbështetje e tillë me mundësi punësim u bë fal punës së IADK-së dhe projektit mbështetur nga donatori BfdW.

Përpunimi i pemëve dhe perimeve në kushte moderne mundëson rritjen e të ardhurave për znj. Naime Haliti nga Komuna e Shtimes. Znj. Haliti, që katër vite merret me përpunimin e pemëve dhe perimeve, deri më tani ato i ka bërë në kushte shtëpie, me paisje shtëpiake.



“Kërkesat për produkte të përpunuar janë gjithmonë në rritje, por kushtet e tilla ma pamundësuan që unë të zgjerohem me biznes, shprehet zonja Haliti”. Obligimet dhe kërkesat familjare gjithmonë shtoheshin, andaj e kisha të pamundur që të mbaj familjen me të ardhurat që kisha mundësi të sigurojë, unë isha e vetme që punoja në familje. Motivi dhe angazhim im ishte që të shikoj për mundësi përmirësimi dhe zgjerimi të biznesit, por mundësitë e mia buxhetore ishin tepër të limituar. Unë arrita të bie në kontakt me organizatën IADK me projektin e financuar nga CFD dhe të shprehë interesin tim dhe planin për përmirësim dhe zgjerim të biznesit. Jam shumë faleminderues për mbështetjen që më është ofruar, sot unë kam të gjithë paisjet e nevojshme

për përpunim në kushte moderne, mbi të gjithë profesionalisht dhe teknikisht jam e përgatitur falë trajnimeve të ofruara. Një mundësi të tillë, IADK përmes projektit DRC ja ofroi edhe zonjës Milena Miletic nga Komuna e Zveçanit, e cila për një kohë të gjatë merrej me konservimin e pemëve dhe perimeve në kushte shtëpie. Falë mbështetjes me linjën e përpunimit, sot zonja ka biznesin e saj personal, ajo prodhon produkte cilësore, puna e saj është më e lehtë dhe klientët e saj janë të kënaqur me cilësinë e produkteve që zonja ofron.

Prodhimi i ëmbëlsirave në kushte moderne mundësi punësimi për gratë, këtë më së miri e shfrytëzuan znj. Shkurte Topalli nga Komuna Ferizaj, znj. Sahadete Ibrahim nga Lipjani dhe znj. Bukurie Berisha nga Vitia. Zonjat u mbështetën në hapjen e bizneseve, me linjën e nevojshme dhe profesionale për prodhimin e ëmbëlsirave.



Ato sot, kanë krijuar identitetin e biznesit të tyre falë mbështetjes edhe me logo, barkode dhe etiketa që mundëson atyre plasimin më të lehtë të produkteve në treg. Znj. Topalli, ka arritur të përvetësojë praktika të mira në prodhimin e ëmbëlsirave falë trajnimeve, sot ajo shfrytëzon paisjet dhe njohurinë e përfituar në prodhimin e ëmbëlsirave dhe shet ato me emrin e biznesit Lord's Sweet. Znj. Topalli, znj. Ibrahim dhe znj. Berisha, sot gëzojnë një punë të sigurtë, me punën që bëjnë ato krijojnë të ardhura për vete dhe familjen.

Bizneset tona janë të reja, ne besojnë se do të kemi të hyra ekonomike, duke na mundësuar të kemi një jetë më të mirë për ne dhe familjet e tona, për këtë ne jemi falënderuese për organizatën IADK dhe projektet e financuar nga BfdW, CFD dhe UNDP.

7. Bimët Mjekuese dhe Aromatike si sektor potencial për punësim, gjenerim të ardhurave dhe rritje të eksportit

Kosova njihet me potencialin e saj në grumbullimin natyral dhe kultivimin e një numri të madh të bimëve medicinale dhe aromatike (BMA). Kushtet agrometeorologjike, reliefi dhe plleshmëria e tokës mundëson që në Kosovë të prodhohen një numër i madh i BMA-ve që janë më se të kërkuara në tregun e BE. Kohëve të fundit, kultivuesit, grumbulluesit dhe përpunuesit e BMA-ve kanë shtuar kapacitetet teknike dhe profesionale, dhe kjo ka bërë të mundur që kërkesa e tregut të BE për BMA të jetë shumë më e madhe. Të dhënat statistikore tregojnë që janë rreth 170 ha me bimë të kultivuara dhe rreth 824,379 ha – zona të certifikuar për grumbullimin e tyre natyral.



Pa dyshim, një rol të rëndësishëm në këtë drejtim ka luajtur organizata IADK me projektin e financuar nga GIZ Gjerman. IADK ka mbështetur këtë sektor duke ndihmuar në rrijen e sipërfaqeve me BMA dhe njëkohësisht duke krijuar lidhshmërinë e prodhuesve me grumbulluesit dhe përpunuesit e tyre.

Fidanë të BMA	Serra Tharëse 30m ²	Serra Tharëse 50m ²	Serra Tharëse 80m ²	Serra Tharëse 100m ²	Mekanizëm bujqësor	Serrë 200m ² për kultivim të BMA	Makinë për prerje të mollës	Tharëse termike 12m ²
37 fermerë mbështetur me fidanë të BMA	3 fermerë mbështetur me serra tharëse 30m ²	34 fermerë mbështetur me serra tharëse 50m ²	48 fermerë mbështetur me serra tharëse 80m ²	12 fermerë mbështetur me serra tharëse 100m ²	98 fermerë mbështetur me motokultivatorë	1 pikë grumbulluese mbështetur me serrë 200m ² për kultivim të BMA	3 fermerë mbështetur me presa të mollave	2 pika grumbulluese të mbështetura me tharëse termike 12m ²
								

Z. Sylejman Kastrati, nga fshati Vërboc, Komuna Drenas, është një nga 111 përfituesit e IADK-së, ai ka filluar të kultivojë bimën e hithërit, duke pasur parasysh përfitimet nga kjo bimë. Z. Kastrati është aktiv në bujqësi për një kohë të gjatë, duke u marrë me kultivimin e bimëve lavërtare.

Mirëpo, përfitimet e ulëta kanë shtyrë Z. Kastrati që të shikojë mundësi të tjera, dhe pikërisht është kultivimi dhe tharja e BMA-ve që sot ai merret. Toka e përshtatshme, plleshmëria e saj kanë motivuar atë dhe shumë të tjerë që të mbjellin mbi 0.20 ha me BMA si hithër, mentë, kalendulë, rigon etj. Me ndihmën e IADK-së, sot unë dhe shumë fermer të tjerë kemi një stabilitet ekonomik dhe atë fal kultivimit të BMA-ve, grumbullimit të tyre dhe tharjes së tyre në tharëse duke filluar prej 50 m² të mbështetur nga IADK.

Fitimet e marra nga kjo kulturë, duke vjelur rreth 1000 kg dhe duke përfituar 800 EURO më kanë shtyrë mua dhe shumë fermerë të tjerë në zgjerimin e sipërfaqeve që nga viti i ardhshëm. Investimet e tilla pa një lidhshmëri me këshilla praktike dhe profesionale janë shumë të mangëta, andaj IADK ka mundësuar që përfituesit të përcjellin një gamë të trajnimeve me qëllim përdorimin e praktikave të mira bujqësore.

Përveç prodhimit dhe rritjes së sipërfaqeve me BMA, IADK ka ndihmuar edhe në stabilitetin e grumbullimit të tyre dhe tharjes. Konsiderohen rreth 57 qendra grumbulluese në nivel të Kosovës me mbi 3,200 grumbullues. Shumica e produktit është për tregun e BE nga ku 95% e produktit shkon si gjysmë përpunuar.



Në zhvillimin e më tutjeshëm të sektorit, IADK ka ndihmuar në krijimin e pikave grumbulluese dhe tharëse. Një nga shumë përfituesit është edhe qendra grumbulluese "Ari & Leo" përfaqësuar nga Z. Njazim Hasani, fshati Çabër, komuna Zubin Potok. Kjo qendër është e vetmja në Komunën e Zubin Potokut, operon që 15 vite dhe bënë grumbullimin e BMA-ve nga të gjithë kultivuesit dhe grumbulluesit. Z.Hasani shprehet shumë mirënjohës për këtë qendër grumbulluese, pasi më parë BMA-të janë tharë në kushte natyrale dhe pa kontroll, e që ka rezultuar me humbjen e vlerave ushqyese dhe medicinale.

Investimet e tilla të bëra në bashkëpunim me IADK-në kanë përmirësuar kushtet e tharjes, kanë ndikuar në rritjen e cilësisë së tharjes dhe mbi të gjitha kanë ndikuar në rritjen e kultivuesve dhe grumbulluesve të BMA-ve. Andaj, unë sot me pikën tharëse prej 12m2 kam grumbulluar dhe tharë 10,000 kg dhe kam krijuar 14,000 euro të ardhura. Përfitime të ngjashme kanë edhe 2 pika tjera grumbulluese dhe tharëse të cilat janë mbështetur nga IADK në kuadër të projektit për bimë mjekësore "Mbështetja e zinxhirit të vlerave të BMA përmes krijimit të punësimit dhe vazhdimit të eksportit" përkrahur nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, mandatuar nga Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë.







8. Kultivimi i perimeve në serra, mundësi punësimi dhe krijimi të të ardhurave për fermerët



Sektori i perimeve luan një rol shumë të rëndësishëm në ofrimin e mundësive për punësim dhe krijim të të ardhurave. Pavarësisht shtrirjes së vogël, sektori i perimtarisë është premtues, pasi ka kushte të mira kultivimi dhe mund të sigurojë rritje të mirë të vlerës së shtuar. Në përgjithësi, ky sektor karakterizohet nga një numër i vogël i kultivuesve komercialë, shumica e kultivuesve janë prodhues me sipërfaqe të vogla. Megjithatë, sektori i perimeve gjatë vitit 2019 ka qenë mjaft stabil, në përgjithësi sasia e prodhimit dhe cilësisë së produkteve perimore ka qenë e kënaqshme. Pjesa më e madhe e prodhimit është shitur në tregun vendor dhe një pjesë është edhe eksportuar. Pavarësisht zhvillimeve pozitive, sektori i perimeve kërkon mbështetje të vazhdueshme, me theks në ngritjen e kapaciteteve teknike dhe profesionale, gjithashtu në shtimin e sipërfaqeve dhe lidhjen e fermerëve me tregun. Në këtë drejtim, një rol të rëndësishëm ka luajtur edhe organizata IADK në kuadër të projekteve të ndryshme të financuar nga donator si GIZ, CFD, BfdW, DRC etj.

Një nga 75 përfituesit e IADK-së për vitin 2019 është edhe znj. Sevdije Hasani nga Skënderaj e cila së bashku me familjen qëndroi për një kohë në Gjermani me arsyen që të ketë një jetë më të mirë për vete dhe familjen. Jeta në Gjermani filloi të bëhej e vështirë, pjesa më e madhe e familjes ishte

në Kosovë, ne nuk kishim atë që ëndrruam të kemi në Gjermani, prandaj vendosëm të kthehemi në Kosovë.



Jeta në fshatin Ticë ishte e vështirë, papunësia është shumë e lartë dhe e vetmja mundësi për krijim të të ardhurave ishte bujqësia, prandaj ne filluam të shikojmë për mundësi punësimi. "Bujqësia ishte gjithmonë ëndrra ime, por për shkak të kushteve financiare, unë nuk munda të realizojë atë.

75 përfitues me serra mbështetur nga IADK

GIZ_R

34 Serra 200 m²

Fidane, Sistem të ujitjes kompletë, inpute përcjellëse dhe këshilla direkte

19 Serra 160 m²

Fidane, Sistem të ujitjes kompletë, inpute përcjellëse dhe këshilla direkte

BftW

DRC

8 Serra 160 m²

Fidane, Sistem të ujitjes kompletë, inpute përcjellëse dhe këshilla direkte

14 Serra 100 m²

Fidane, Sistem të ujitjes kompletë, inpute përcjellëse dhe këshilla direkte

CFD

Mirëpo, fatmirësisht unë erdha në kontakt me IADK-në, bashkëpunimi me organizatën rezultoi të ishte shumë i suksesshëm, pasi ne patëm mundësi që të përfitojmë një grant për ndërtimin e serrës me sipërfaqe prej 200m², me inpute tjera përcjellëse dhe me fidane. Ideja e ndërtimit të serrës dhe përcjellja me trajnime teknike dhe profesionale ishte një mundësi e mirë për përmirësimin e mirëqenies për mua dhe familjen time. Që nga koha kur kam marrë mbështetjen dhe kam filluar të merrem me kultivimin e

perimeve në serra, unë kam përmirësuar jetën e familjes duke gjeneruar të ardhura mbi 1,200 euro”.

Një fat të tillë si rezultat i ndihmës nga organizata IADK gëzojnë edhe 75 fermerë, në vendet ku operon organizata IADK. Pothuajse të gjithë, kanë gjeneruar të ardhura deri në vlerën prej 1,600 euro, të ardhurat do të vazhdojnë të rriten në të ardhmen.

9. Kultivimi i pemëve sjellë përfitime afatgjate për përfituesit e IADK-së



Kosova bënë pjesë në grupin e shteteve me kushte të volitshme agroekologjike për kultivimin e pemëve. Aspektet ekonomike janë të përshtatshme për zhvillimin e pemëtarisë, falë këtyre mundësive, kultivimi i pemëve është më se i mundshëm, është rentabil nga ku mund të sigurohen fruta me cilësi dhe sasi të lartë. Në Kosovë llogaritet që janë diku 6,420 ha me pemë, rritje të theksuar kanë molla, arra, mjedra dhe boronica. Sipas të dhënave statistikore ka një trend pozitiv në zhvillimin e sektorit të pemëve, një rol në zhvillimin e sektorit ka luajtur edhe organizata IADK me projektet e ndryshme të financuar nga donatorët si GIZ, KCSF-Y dhe DRC. Me përkrahjen e donatorëve, IADK ka mbështetur grupe të ndryshme të përfituesve.

Fillimisht janë analizuar nevojat e sektorit dhe aplikuesve, nga ku më pas janë përgatitur pakot mbështetëse të cilët do të shërbejnë për zhvillim të sektorit të pemëve.



Në kuadër të projektit për të rikthyer, financiar nga GIZ Gjermanë janë mbështetur një grupe e caktuar, përsona të rikthyer të cilët kanë gatishmërin dhe potencialin për kultivimin e pemëve. Gjithashtu edhe donatori DRC ka mbështetur sektorin e pemëve. Dy donatorët e lartëpërmendur përmes organizatës IADK kanë ndihmuar në shtimin e sipërfaqeve me arrë, dhe duke mbështetur përfituesit me fidane arre, sistem komplet të ujitjes, shtylla & tel rrethues dhe inpute shtesë. Fal kësaj mbështetje sot kemi 2.30 ha sipërfaqe më shumë me kulturën e arrës.

Po ashtu edhe praktikat e mira bujqësore janë përmirësuar si rezultat i mbështetjes me mekanizëm bujqësor të nevojshëm dhe të përdorshëm në kultivimin e pemëve.

Gjithashtu, IADK me projektet e saj ka kontribuar edhe në përmirësimin dhe lehtësimin e punëve në sektorin e pemëve duke përkrahur të rinjë dhe të reja me anë të mbështetjes me pajisje esenciale në kuadër të projektit të financuar nga KCSF-Y.



Një nga përfituesit e IADK-së është fermeri nga fshati Runik i Komunës së Skënderajt, i cili për një kohë jetoi në Gjermani me qëllim të një jete më të mirë. Kreshnik Ademi, si 29 vjeq filloi kultivimin dhe zgjerimin e sipërfaqeve me kulturën e arrës. Falë mbështetjes së IADK-së, tani ai posedon 50 ari sipërfaqe me arrë nga ku pret që në të ardhmen të fillojë të vjelë të mirat nga kjo kulturë.

Parcela me këtë sipërfaqe është kompletuar falë kontributit të organizatës me fidane, sistem të ujitjes dhe inpute tjera. Kreshniku ka ngritur njohurit e tij në kultivimin e pemëve, menaxhimin të përmirësimit, dhe zotohet se do të rrisë sipërfaqen me këtë kulturë në të ardhmen.

10. Blegtoria një sektor me potencial për punësim dhe gjenerim të të ardhurave

Blegtoria njihet si një sektor mjaft stabilë, kohëve të fundit ka një përparim në kuptimin e përmirësimit të racës, cilësisë dhe sasisë së prodhimit. Pavarësisht trendeve pozitive, sasia e prodhimit të qumështit vazhdon të jetë për 2.4 herë më e vogël krahasuar me shtetet Evropiane. Me qëllim që të përmirësojë cilësinë dhe sasinë e qumështit, rol të rëndësishëm po luan organizata IADK me projektet e saj.

Në këtë drejtim, në kuadër të projekteve BfdW dhe GLZ janë targetuar dhe mbështetur një numër i konsiderueshëm i fermerëve, të rinjëve, të rikthyer dhe grupeve të marginalizuara.

Z. Labinot Veseli, 26 vjeqar është një nga 79 përfituesit e IADK-së në blegtori (bletari, paisje për bletari, mekanizëm bujqësorë). Labinoti si shumë të rinjë ka migruar në Gjermani me qëllim që të ketë një jetë më të mirë dhe një punë të sigurtë.



Qëndrimi në Gjermani nuk ishte ashtu siç e kisha pritur, mundësitë për punë dhe jetë më të mirë ishin vetëm një ëndërr prandaj edhe vendosa të kthehem në Kosovë.

Jeta në një familje prej nëntë anëtarëshe, ku asnjë nga ne nuk punonte ishte mjaftë e vështirë. E vetmja mundësi e punës në fshatin ku jetoja ishte blegtoria.

Ëndrrat e mia gjithmonë ishin që të zgjeroja sipërfaqet punuese, të përmirësojë kushtet në shtallë dhe të rrisë cilësinë e qumështit. Mirëpo, mundësitë e limituara financiare nuk ka mundësuar që të bëja investime në këtë drejtim.



Falë bashkëpunimit të mirë me IADK-në unë dhe shumë të rinjë, të reja dhe fermer jemi përkrahur dhe vazhdojmë të përkrahemi me mekanizëm bujqësor dhe këshilla për praktika të mira bujqësore.

Duke qenë shumë i interesuar për të punuar në bujqësi, posaqërisht blegtorinë dhe duke konsideruar faktin e posedimit mbi 7ha tokë, së bashku me stafin e IADK-së kemi dizajnuar paketën e përshtatshme që përfshinë trajnime dhe investime.

Plani për investime në mekanizëm bujqësorë (kositëse të barit, spërkatëse, shpërndarës të plehut dhe makinë mjelëse) ishte mjaft i suksesshëm, pasi rezultoi me zgjerimin e fermës bujqësore, diversifi-kimin e kulturave bujqësore dhe përmirësimin e cilësisë së qumështit.

Megjithatë, granti pa përcjellje të trajnimit është i pa favorshëm, falë IADK-së unë dhe shumë të tjerë kam rritur njohuritë në përdorimin e paisjeve, mbjelljen e kulturave bujqësore dhe menaxhimin e suksesshëm të sektorit të blegtorisë. Investimi kontribuon në mirëqenie dhe ofron një shpresë për mua, familjen time dhe të kthyerit e tjerë në Kosovë.



Zgjerimi i biznesit me qëllim rritjen e të ardhurave ka qenë gjithmonë qëllimi im dhe shumë të tjerëve, andaj kjo tani është bërë realitet, për këtë do të jemi gjithmonë falenderues projektit për të rikthyerit dhe IADK-së, përfundon storien Z.Veseli.




Një vlerë e shtuar për IADK-në, është edhe ri-akreditimi dhe rivalidimi nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK), nga ku ri vërtetohet IADK si ofrues e kualifikimeve në sektorin e blegtorisë për periudhën tre vjeçare (2019-2022). Gjatë kësaj periudhe IADK, do të ofrojë programe trajnuese për fermerët, të rinjtë dhe grupet e tjera të interesuar për të përfituar njohuri profesionale dhe teknike në sektorin e blegtorisë. Njohuritë e përfituara do të kenë ndikim në përmirësimin e menaxhimit të fermave blegtorale dhe rritjen e të hyrave nga kjo veprimtari. Pas përfundimit të programit trajnues dhe kalimit të testeve kualifikuese, kandidatët do të certifikohen dhe do të marrin titullin "Teknik i Blegtorisë, niveli III sipas AKK", kjo certifikatë është valide dhe e njohur nga të gjithë institucionet vendore dhe ato ndërkombëtare.

11. Përmbledhje të rezultateve

IADK gjatë vitit 2019 ka ndikuar në zhvillimin e sektorëve të ndryshëm në bujqësi, duke mbështetur pothuajse të gjithë sektorët me potencial për zhvillim që do të rezultojnë në punësim dhe gjenerim të të ardhurave për të rinjtë, gratë, minoritet, fermerët dhe grupet e marginalizuara. Viti 2019, konsiderohet si vit mjaft i suksesshëm pasi rezultatet janë të prekshme nga ku janë mbështetur 435 përfitues pothuajse në të gjithë Kosovën.


Donatori	# përfituesve 2019	Gjinia		Përkatësia etnike		
		Meshkuj	Femra	Shqipëtar	Serb	Të tjerë
BftW	49	32	17	46	3	0
KCSF-Y	160	72	88	140	20	0
DRC	10	6	4	8	2	0
GIZ-MAP	114	91	23	101	10	3
GIZ-R	84	72	12	83	0	1
UNDP	2	0	2	2	0	0
CFD	16	0	16	16	0	0
Total	435	273	162	396	35	4

Ndërsa sa i përket sektorëve, numri i përfituesve është pothuajse i njëjtë, në përjashtim të sektori i BMA-ve ku kemi një numër më të madh të përfituesve që vërejtet edhe si rezultat i projekteve dhe donatorëve të involvuar.



12. Publikimet


Me qëllim që IADK të ketë një shtrirje në tërë Kosovën, respektivisht në zonat më të thella rurale, me fokusin e vetëm që të targetojë të gjithë të interesuarit, ata të cilët e meritojnë përkrahjen, gjatë viti 2019 janë përgatitur dhe publikuar broshura të ndryshme, të cilat janë përkrahur financiarisht nga donatorët.



13. Vizitat lokale dhe regjionale

Për gjatë 2019, IADK ka organizuar një numër të vizitave lokale dhe regjionale me qëllim shkëmbimit të përvojave ndërmjet fermerëve, njohjes me praktikën e mira bujqësore në sektorë të ndryshëm bujqësorë. Këto aktivitete janë mbështetur nga donatorët e organizatës si BftW, CFD, GIZ, UNDP, KCSF-Y dhe nga vetë IADK. Gjithashtu përpos vizitave, stafi i organizatës ka përfituar nga vizitat dhe trajnimet e organizuar në vende të ndryshme.

Vizitat Studimore




14. Lista e stafit të IADK-së për vitin 2019

NR.	EMRI MBIEMRI	POZITA	Deri më:
1	ZENEL BUNJAKU	Drejtor Ekzekutiv	
2	ESMA KËPUZI	Udhëheqëse e dep. Financa dhe Administratë	
3	ARIANA PECI	Zyrtare për Prokurim & Administratë	
4	ELHEME SHALA	Asistente e Financave	
5	MAGBULE HYSENI	Udhëheqëse e dep. përpunimit të ushqimit	Prill 2019
6	HAFIZE VESELI SYLEJMANI	Menaxhere e projektit: DRC, UNDP, CFD	
7	HANUMSHAHE ZENELI	Asistente e projektit DRC/Eksperte KCSF-Y & CFD	
8	SYLEJMAN BUNJAKU	Udhëheqës i dep. Hortikulturës	
9	NOVICA MARKOVIC	Inxhinier & Ekspert i Hortikultures	
10	EGZON GËRXHALIU	Menaxher i projektit - GIZ-MAP	
11	FIDAN SKERAJ	Udhëheqëse i dep. Blegtorisë	
12	ARBER HASANI	Asistent i projektit KCSF-Y	Gusht 2019
13	ARGJEND GJINOVC	Zyrtar i Projektit - GIZ-R	
14	SHERIF MEHMETI	Inxhinier i Bujqësisë - Pemëtari	Gusht 2019
15	EGZONA HAJRA	Asistente e projektit - GIZ-MAP	
16	ARTA IBRANI ZHUBI	Menaxhere e Projektit GIZ-R	Shkurt 2019
17	BASRI PULAJ	Menaxher i Projektit GIZ-R	
18	ALBINA TAHIRI	Asistente e Projektit GIZ-R	
19	HALIT GASHI	Inxhinier i Bujqësisë (Ekspert)	
20	GËZIM MURSELI	Inxhinier i Bujqësisë (Ekspert)	
21	EMA KURSHUMLIJA	Asistente e projektit	
22	EDITA MAHMUTI MULA	Inxhinier e Bujqësisë	
23	FJOLLA ZUÇAKU	Asistente për financa dhe admin.	
24	LEART KAMBERI	Inxhinier i Bujqësisë	
25	BEHARE MLINAKU	Asistente e projektit CFD	
26	BESARTA HAJRIZI	Asistente për administratë dhe logjistikë	
27	HASAN CENA	Inxhinier i përpunimit të ushqimit	
28	PETRIT KOCI	Mirëmbajtës i rrjetit/sistemit	
29	FEHMI BASHOLLI	Kujdestar i objektit	Gusht 2019
30	SHKURTE BUNJAKU	Asistente teknike & e projektit	
31	PËRPARIM KASUMI	Mirëmbajtës shtëpiak	

15. Të hyrat e IADK-së nga donatorët për vitin 2019

Viti 2019 është një ndër vitet më të suksesshme për IADK-në si në aspektin e realizimit të aktiviteteve po ashtu edhe në gjenerimin e të ardhurave. IADK ka treguar një qëndrueshmëri financiare, të hyrat gjatë këtij viti janë 1,418,394.11€. Të hyrat e tilla janë krijuar falë punës voluminoze dhe transparencës së treguar, me që rast është ndërtuar edhe një besueshmëri e theksuar me donatorët e ndryshëm.


#	Donatorit/Partnerit	Projekti	Shuma (€)	Përqindja %
1	Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ) GmbH	Mbështetja e zinxhirit të vlerave të MHAP përmes krijimit të punësimit dhe vazhdimet të eksportit	668,233	47.1%
	Fermerët - përfituesit		55,882	3.9%
2	Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ) GmbH	Përfshirja ekonomike e të kthyerve përmes bujqësisë në zonat rurale dhe ngritja e kapaciteteve përmes trajnimit profesional	283,287	20.0%
	Komunat (Drenas, Skënderaj) dhe Fermeret		31,439	2.2%
3	Bread for the World	Mundësimi i vetëpunësimit të të rinjve dhe grupeve të marginalizuara në zonat rurale në Kosovë	151,804	10.7%
	Komunat (Shtime, Ferizaj, Vushtrri, Mitrovicë, Skenderaj) dhe Fermerët		34,817	2.5%
4	Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)	Ndërtimi i kapaciteteve profesionale të të rinjve në sektorin e bujqësisë	67,251	4.7%
	Këshilli Danez për Refugjatë (DRC)		37,658	2.7%
5	Fermerët - përfituesit	Mbështetja e Ndërmarrësisë Shoqërore dhe Promovimi i Fuqizimit Social-ekonomik në Komunitetet Minoritare në Kosovë	3,295	0.2%
	Organizata Feministe e Paqes-cfd		45,000	3.2%
6	Komunat (Shtime, Lipjan) dhe Fermeret	Aftësi profesionale dhe mundësi gjenerimi të të ardhurave në bujqësi për gratë dhe të rinjtë që jetojnë në zonat rurale të Kosovës	7,270	0.5%
	Bread for the World		18,960	1.3%
8	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP)	Mbështetja e grave dhe vajzave në fuqizimin ekonomik përmes vetë-punësimit dhe ngritjes së aftësive të tyre profesionale	13,498	1.0%
Total			1,418,394	100%



16. Të hyrat e IADK-së nga partnerët për vitin 2019

Përpos të hyrave nga donatorët, IADK gjatë vitit 2019 ka pasur të hyra edhe nga partnerët tjerë, kryesisht nga komunat partnere ku janë realizuar aktivitetet që për qëllim ka mbështetjen e fermerëve – përfituesve në sektorët e ndryshëm të bujqësisë.

#	Partneri	Projekti	Shuma (€)	Përqindja %
1	KCSF	Rrjetëzimi dhe Monitorimi i Ligjeve	5,324.0	33.8%
2	Komuna e Shtimes	Shërbimet këshillimore dhe trajnimet për fermerë	2,190.0	13.9%
3	Bioma	Trajnime	1,592.5	10.1%
4	Komuna e Lipjanit	Shërbimet këshillimore dhe trajnimet për fermerë	1,362.0	8.6%
5	Komuna e Ferizajit	Shërbimet këshillimore dhe trajnimet për fermerë	1,116.0	7.1%
6	Komuna e Vushtrrisë	Shërbimet këshillimore dhe trajnimet për fermerë	936.0	5.9%
7	Komuna e Mitrovicës	Shërbimet këshillimore dhe trajnimet për fermerë	816.0	5.2%
8	Care International	Trajnime dhe vizita për fermerë	600.0	3.8%
9	Studentët nga Holanda	Internship	474.6	3.0%
10	Mjedrat e Kosovës	Trajnime	339.0	2.2%
11	Fermerë	Trajnime dhe shërbime këshillimore	310.0	2.0%
12	Caritas	Trajnime	258.6	1.6%
13	Komuna e Leposaviqit	Shërbimet këshillimore dhe trajnimet për fermerë	240.0	1.5%
14	SHG/WA ZGJIMI	Kontabilitet për OJQ	190.7	1.2%
Total			15,749.0	100%





T ë jetojmë nga toka dhe puna jonë



Adresa:
Sfaraçak i Ulët, Nr.11,
42000 Vushtrri,
Kosovë

E-mail: info@iadc.org
Tel: +383 (0) 44 777 036
+383 (0) 49 777 046
Web: www.iadc.org